

Moderatori: mirëdita dhe mirëserdhët. Debatin e sotëm i cili mban temën "EULEX-i në Kosovë pas mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të OKB-së" e organizon Qendra Mediale me mbështetjen e ambasadës Amerikane në Prishtinë. Pjesëmarrës në panel janë: zëdhënësi i UNMIK-ut Alleksandar Ivanko, Viktor Rojter, drejtor i zyrës për informim të EULEX-it, Endi Mekgafi zëdhënësi i Zyrës Civile Ndërkombëtare, avokati Azem Vllasi dhe kryetari i Lëvizjes së Rezistencës Serbe Momçillo Trajković. Si rëndom fjala hyrëse është e paraparë të zgjas deri pesë minuta. Ju lutemi që t'i përmbahemi rendit të ditës dhe kohës ashtu që gazetarët të kenë mundësi të bëjnë pyetje. Do të fillojmë me përfaqësuesin e UNMIK-ut, zotin Ivanko, urdhëroni.

Alleksandar Ivanko: mirëmëngjesi të gjithëve. Ju falemnderit që keni ardhur. Pas vendimit të Këshillit të Sigurimit nuk është si më parë. EULEX-i do të fillojë me shtrirjen e shpejtë dhe UNMIK-u do të tërhiqet shumë shpejt. Do të shihni më pak polic të UNMIK-ut dhe atëherë kur EULEX-i të shtrihet plotësisht, polici të UNMIK-ut nuk do të ketë më. Nuk e di a keni pasur rastin të shihni intervistën e djeshme të ambasadorit të PSSP-së Zanieri, e cila është botuar sot. Ai e ka thënë mjaft qartë që nuk do të ketë imponim të gjashtë pikëve. Vendimet që do të merren do të jenë në mënyrë strikte në koordinim me Qeverinë në Prishtinë. Kështu që në muajt në vijim do të na shihni gjithnjë e më pak. Po ia jep fjalën Viktorit.

Viktor Rojter: falemnderit Aleksandër. Mirëmëngjesi të gjithëve. Siç ka qenë edhe e paralajmëruar, misioni do të fillojë me shtrirjen e mandatit të tij në fillim të dhjetorit e më tutje. Deri atëherë do të kemi 1300 ndërkombëtarë dhe disa qindra staf lokal në teren të cilët do të na mundësojnë të arrijmë masën kritike për të filluar me zbatimin e mandatit, për aftësinë fillestare operative. Misioni do të jetë plotësisht operativ deri në fund të dimrit, për disa muaj kur në përbërjen e tij do të jenë rreth 2900 ndërkombëtarë dhe 1100 staf lokal. Pse jo 2 dhjetori, pse 9 dhjetori? Ne gjithmonë kemi thënë që kjo do të jetë në fillim të dhjetorit. Dëshëm që të gjithë të kënaqen gjatë festës së 8 dhjetorit, kështu që vendosëm për 9 dhjetor. Ne, më 5 dhjetor i dërgojmë raport udhëheqësve tanë politik në Bruksel për gatishmërinë tonë, të cilët do të informojnë ambasadorët e vendeve të BE-së. Neve na duhet një fillim i qartë dhe i mirë. Nuk ka kuptim të shpejtohen gjërat për 2-3 ditë. Nga e marta e tutje do të shihni polic të EULEX-it, gjyqtarë të EULEX-it, prokurorë, personel të EULEX-it që punon nëpër burgje, zyrtarë të EULEX-it për dogana, të cilët punojnë së bashku me bashkëpunëtorët e tyre. Si një përkujtim, pse jemi ne këtu? Ne jemi këtu të ndërtojmë strukturat e sundimit të ligjit në përputhje me standardet evropiane dhe detyra jonë kryesore do të jetë përcjellja e punës dhe ofrimi i ndihmës. Për disa raste të veprave penale kemi raporte, edhe pse konsiderojmë që kolokacioni është mënyra më e mirë për t'u përmirësuar standardet në dobi të popullatës kosovare dhe ne jemi të gatshëm të fillojmë me zbatimin e mandatit që sot. E thashë në fillim arsyen se pse po fillojmë me zbatimin e mandatit më 9 dhjetor dhe që punën tonë e fillojmë në koordinim të ngushtë me

UNMIK-un. Ju falemnderit.

Endi Mekgafi: Ju falemnderit shumë dhe e uroj Qendrën Mediale për organizimin e debatit të sotëm. Ky është një institucion fantastik. ICO është një organizatë e formuar nga 25 shtete, të cilat e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Ato janë të njohura si grupi ndërkombëtar udhëheqës, ato përfshijnë disa nga vendet e BE-së, si dhe SHBA-të, Turqinë dhe Kroacinë. Siç e dini, ne e këshillojmë dhe kontrollojmë punën e Qeverisë së Kosovës në zbatimin e propozimit gjithpërfshirës të zgjidhjes së statusit të Kosovës. ICO-ja e përshëndet debatin në KS për shtrirjen e EULEX-it dhe me të vërtetë grupi ndërkombëtar udhëheqës në pjesën e tij përshëndet shtrirjen e afërt të EULEX-it në Kosovë në bazë të raportit të tij të nëntorit të këtij viti. Ky është një lajm i mirë për të gjithë ne në Kosovë. Kjo do të jetë e dobishme për të gjithë qytetarët, përmes forcimit të sundimit të ligjit dhe ne besojmë që kjo është diçka që njerëzit në Kosovë e dëshirojnë. Ne presim shtrirje të shpejtë të cilën e këshillon edhe Piter Feith. Ne përshëndesim faktin që EULEX-i do të veprojë me Qeverinë e Kosovës dhe ICO-në do të vazhdojë të bëjë përpjekje për vendosjen e një shoqërie multietnike dhe demokratike në të cilën do të respektohen të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe individëve dhe në lidhje me këtë ne përshëndesim kontributin e dhënë për arritjen e këtij qëllimi.

Azem Vllasi: UNMIK-u është mision me mandat të mbaruar dhe në tërheqje e sipër, nuk është pushtet mbi pushtete në Kosovë. Detyra e UNMIK-ut, në përputhje me rezolutën 1244 të KS-së, është që të ndihmojë si ombrellë në shtrirjen e EULEX-it në një periudhë maksimale prej katër muajsh, siç tha zoti Zanieri. Rezoluta 1244 e KS-së, siç u tha nuk e vazhdon jetën dhe pushtetin UNMIK-ut, por është marrë si pretekst që Rusia të mos shkaktojë probleme para KS-së dhe për të lehtësuar pozitën e Serbisë para opinionit, ashtu që të mos bëjë probleme në shtrirjen e EULEX-it edhe në veri. Sipas përkufizimit, detyrës dhe planit të Ahtisarit, misioni i EULEX-it nuk është vetëm zëvendësimi i UNMIK-ut, por edhe mbështetja dhe ndihma sistemit gjyqësor, policor dhe doganor të Kosovës, për t'u aftësuar në funksionimin sipas standardeve evropiane. UNMIK-u dhe EULEX-i nuk janë në Kosovë sipas dëshirës së Serbisë, por shkak të nevojës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës. Çka do të thotë edhe për serbët e Kosovës. EULEX ka kuptim vetëm nëse shtrihet në tërë teritorin e Kosovës, e para së gjithash në veri sepse atje ka mbetur një vakum dhe zbrazësi ligjore gjë që ka kontribuar në krijimin e oazave të kriminalitetit të të gjitha llojeve. EULEX-i asesi nuk duhet të jetë këtu me qëllim të ndarjes por integritetit. Sepse vetëm kështu do të kryejë misionin e tij dhe do t'i shërbejë stabilitetit të Kosovës dhe regjionit. EULEX-i nuk vie që të merret me statusin e Kosovës, por vie në një shtet të pavarur statusi i së cilës është zgjidhur. Ky është misioni i EULEX-it, në përbërjen e të cilit janë 24 shtete që e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. EULEX-i nuk mund të injorojë planin e Ahtisarit, pasi që edhe vetë është pjesë dhe produkt i atij plani i cili është përcaktuar me këtë plan dhe atë 24 shtete nga 52 sosh që e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Ky është shtet i projektuar sipas planit të Ahtisarit. Retorika e zyrtarëve të Beogradit se është ruajtur integriteti i Serbisë ndaj Kosovës është për konsumim të brendshëm. Pretendimet dhe premtimet e Beogradit që të udhëheq me serbët e Kosovës përmes EULEX-it duke injoruar dhe duke luftuar kundër shtetit të Kosovës aty ku jetojnë serbët, është një shërbim i keq që iu bëhet serbëve të Kosovës.

Kudo që do të ekzistojë EULEX-i do të jenë edhe institucionet e Kosovës. EULEX-i do të na ndihmojë neve dhe ne do t'ju ndihmojmë atyre për të na ndihmuar neve. Serbia nga EULEX-i në Kosovë, së bashku me propozimin i cili iu dorëzua gjyqit ndërkombëtar për shpalljen e pavarësisë ka një dobi, që Kosova të jetë një patate e nxehtë ku nuk mund të ndryshojë asgjë. Duke vepruar kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare, kundër politikës kosovare, shqiptare, Serbia nuk shkon në drejtim të integritit. Shteti i Kosovës është produkt i vullnetit të qytetarëve dhe rrethanave historike pas shpërbërjes së RSFJ-së. Ky është projekt yni dhe i Kosovës dhe Amerikës, i cili nuk do të shkatërrohet sepse nuk ka alternativë tjetër. Askush, as projektuesit e këtij shteti, Serbia, as serbët e Kosovës nuk kanë interes që të kthehemi në gjendjen para shpalljes së pavarësisë. Sa më parë që të normalizohen marrëdhëniet me Kosovën dhe të pranohet ky shtet si dhe shtetet tjera që u krijuan me shpërbërjen e RSFJ-së, Serbia do të jetë në fitim. Ekziston bindja që EULEX-i do të ndihmojë në këtë drejtim.

Momqillo Trajković: Mua nuk më pëlqen rrjedha e sotme e diskutimit apo shpjegimit nga një arsye themelore që po relativizohet një balans i cili u vendos me ndarjen e Kosovës në nivel të KS-së. Edhe ne që pretendojmë të merremi me politikë, në veçanti ata që marrin pjesë në zbatimin direkt të politikës nuk do të duhej lënë anash atë rezultat kyç të KS-së me rastin e raportit të Sekretarit të Përgjithshëm me rastin e gjashtë pikave. Nuk e shoh fitoren e Serbisë me ato gjashtë pika, por nuk e shoh as fitoren e Kosovës. Tim Xhuda e tha këtë më së miri: “as nuk e ka ruajtur Serbia integritetin në këto hapësira, siç po shihet, as që shqiptarët e kanë pavarësinë e plotë në këtë teritor.” Kjo flet që na pret një diskutim i madh politik, luftë politike, dialog në kërkimin e zgjidhjes. Po të mos ta kishte shpallur Kosova njëanshëm pavarësinë, atëherë unë do të kisha pranuar diskutime të tilla. Pasi që njëanshëm është shpallur pavarësia, të gjitha problemet e mëvonshme dalin nga kjo. Tani kemi një situatë që mund të bisedojmë. Është gjë e mirë që EULEX-i do të marr detyrën e vet këtu. Nuk është mirë që nuk ekziston asnjë pushtet normal këtu, veçanërisht ky pushtet që nuk është në gjendje të rivendos as sovranitet, as shtet juridik në një mjedis që është katastrofal. Nuk e di a do të kishte mundur dikush tjetër të vendoste pas tërë asaj që ka ndodhur, në një krizë të këtillë socio-ekonomike, një shtet normal. EULEX-i është i mirëseardhur dhe unë e përsëris dhe konsideroj që duke respektuar vendimin e BE-së ne duhet të marrim pjesë në gjetjen e zgjidhjes, krijimin e shtetit juridik, pushtetit juridik. Mendimi in është që statusi nuk është zgjidhur pasi që pavarësia është shpallur në mënyrë të njëanshme. Unë do të përkujtoj, nuk e di sa ka ngjashmëri, por Millosheviqi në vitin 1998 e ka pasur një situatë ndoshta të ngjashme me këtë që e kemi sot. E ajo ishte që UÇK-ja kontrollonte gjysmën e Kosovës. Ai e ka pasur problem se çka të bëjë! A të vështroj se si UÇK-ja ngadalë po e zgjeron ndikimin e saj apo të bisedojë me ta, ata nuk deshën të bisedonin, apo të marrin armët, dhe erdhën deri ku erdhën. Pra, tani e kemi situatën që nuk është gjë e mirë injorimi i atij qëndrimi të serbëve, me kusht që edhe të jetë i gabueshëm nga kjo ana tjetër. Por duhet të gjenden mënyra se si të hapet biseda, të kërkohet kompromisi i cili, thënë kushtimisht, do t'i kënaqte të gjithë. Sot e kemi situatën që në një të tretën e teritorit jetojnë serbët, por nuk janë një e treta në strukturën e banorëve. Dhe këta banorë nuk e pranojnë shpalljen e njëanshme të pavarësisë së shtetit të pavarur të Kosovës. Dilema e njëjtë, duan të bisedojnë me serbët, serbët nuk duan të bisedojnë nga ato pozita të Kosovës së pavarur. Të vështrojnë se si serbët po krijojnë pushtetin paralel? Kjo shpallje e njëanshme e pavarësisë është qartazi nervoze. Sa i përket asaj të tretës, armëve dhe forcës, kjo mendoj do të ishte katastrofë e vërtetë. Këtu janë edhe forcat

ndërkombëtare për të amortizuar pakënaqësitë si të njërit ashtu edhe të tjetrit dhe të krijojnë hapësirë politike që ne ende të vazhdojmë të bisedojmë, të kërkojmë përgjegje në atë pyetje. Aty është problemi kyç. Pra cili është problemi kyç? Unë para dy vitesh kam thënë qartë se ku është problemi. Me armiqësi dhe armë kundër Serbisë nuk mund të krijohet shteti i pavarur, ai mundet vetëm të vegjetojë, por do të ketë probleme. Dikush me të drejtë tha: “dikush nuk e sheh elefantin në shtëpi”. Ai elefant është Serbia, d.m.th serbët e Kosovës dhe Metohisë. Tani Azemi thotë pse serbët e kanë pushtetin e tyre këtu? Po ju lutem unë do ti lë të gjitha këto. Serbët sot i financon shteti i Serbisë, standardi i së cilës është shumë më i fuqishëm se i këtij shteti të Kosovës. Për shembull si do të mund dikush të lë standardin e punëtorëve të arsimit. Çfarë pagash marrin punëtorët e arsimit që i financon Kosova e sa marrin ata që i financon Serbia? Do ti lëmë të gjitha 500, 600 apo 1000 € për 250€?! Pra çka dua të them? Dua të them që kjo shoqëri nuk është pjekur që të bëjë për vete, në veçanti jo në mënyrën se si dëshiron t’i kthejë për vete banorët tjerë që nuk e pranojnë atë pavarësi, as ekonomikisht, as në mënyrë sociale as politike. Në fillim të proceseve politike dëshirohet çdo gjë. Kjo shoqëri ende nuk ka përgjegje për proceset demokratike. Kur të mbyllen disa probleme, ja edhe kjo me EULEX-in dhe të hyjmë shpresoj në disa ujëra më të qeta, do të shtrohet çështja socio-ekonomike në të cilën duhet të gjendet përgjegjja. Dua të konkludoj me këtë: pa marr parasysh se kush si e interpreton, unë nuk do të interpretoja ashtu që këto gjashtë pika nuk janë të rëndësishme, do të krijojnë shtetin e pavarur. Të shfrytëzojmë EULEX-in jo si institucion i cili do të krijojë shtetin e pavarur apo të mbështes Serbinë, etj, etj... Kjo nuk është gjë e mirë. Të shfrytëzojmë EULEX-in dhe UNMIK-un dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare që gjenden këtu ashtu që të krijojmë një hapësirë politike që të mund të bisedojmë dhe të kërkojmë zgjidhje, sepse pavarësisht se kush çka thotë këtu zgjidhje nuk ka dhe se vështirë do të gjendet dhe vetëm e lus zotin që ta kërkojmë zgjidhjen me mjete politike, ky është thelbi e jo që ne të eliminojmë disa përparime dhe disa balanse të cilat kanë krijuar një mjedis për kompromise bile në këtë fazë, kompromise për një jetë pranë njëri tjetrit. Unë jam i sigurt që nëse ekonomia ngjallet këtu dhe nëse gjejmë përgjegje në disa çështje të mëdha, do të gjendet edhe zgjidhja për jetë të përbashkët. Unë jam ithtar i EULEX-it si një mundësi e jona, e jo si EULEX që ka ardhur të mbështes njërin apo tjetrin. Nuk kanë ardhur ata as për njërin as për tjetrin, ata janë këtu të vendosin shtetin juridik, pushtetin që këtu do të kontrollojë raportet politike dhe të përgatis, do të thoshte Serbia, një pjesë të Serbisë, për të hyrë në BE, këtu do të thoni Kosovën, për hyrje në BE. Le të interpretojë çdokush ashtu si të dojë, por proceset politike do të japin përgjegje në ato pyetje. A është pushteti në Beograd dhe autoritetet në Kosovë në binarë të njëjtë sa i përket proceseve demokratike? Unë mendoj që kjo lëvizje para e Serbisë, po le të mos jetë edhe aq e madhe, janë në esencë procese të fuqishme demokratike që fitojnë garanci dhe njohje nga bashkësia ndërkombëtare që disa gjëra po lëvizin përpara. A është pushteti në Kosovë në të vërtetë në rrugën e demokratizimit, edhe pse do ta dëshironin këtë, ajo strukturë shumë vështirë do të mund të dal në një rrugë demokratike, sepse me një situatë të këtillë socio-ekonomike ajo nuk ka bazë për të forcuar proceset demokratike. Në këtë kutrim mesazhi është: proceset demokratike në Serbi, repsektivisht në Kosovë, janë shansi ynë për t’u afruar, që këta që kanë ardhur të na ndihmojnë që të gjejmë përgjegje në këtë pyetje tonë.

Bahtir Cakolli-TV 21: Është interesante që ju njëherë më heret në një mbledhje keni thënë që ne e pranojmë realitetin në Kosovë, shtetin e Kosovës, kjo ishte atëherë kur flitej për projektin Graçanica e re, kur u desh të fitohej një donacion i huaj , tani e thoni të kundërtën. A prisni

ndihmë nga EULEX-i apo do të vazhdoni të jeni pjesë e Serbisë dhe që prapë Serbia dhe Beogradi të manipulojë këtu?

Viktor Rojter: Nuk do të ketë zhvillim ekonomik nëse nuk keni sundim të ligjit. Sundimi i ligjit është diçka që vjen i pari dhe pas tij nuk vie çdo gjë në mënyrë automatike. Ju e dini që ne bashkëpunojmë në parimin e banorëve lokal. Popullata lokale duhet ta jap kontributin e saj në këtë çështje. Nëse nuk keni sundim të ligjit, nuk do të keni mjetet më të mira për punë. Synimi ynë kryesor është që të ndërtojmë strukturën dhe sistemin, natyrisht përfshirë edhe sistemin juridik i cili ekziston në nivel të BE-së. Të gjitha do t'i bëjmë në parim të bazës sonë ligjore e cila është dakorduar në shkurt nga ana e 27 shteteve anëtare të BE-së dhe jo vetëm të atyre që e kanë njohur statusin e Kosovës dhe ky dokument vendos të gjitha detyrat që duhet t'i plotësojmë dhe mënyrën se si duhet ta zbatojmë atë. Kështu që do të bëjmë të gjitha ato që dalin nga ai dokument.

Momqillo Trajković: Unë kam folur duke pasur parasysh realitetin. Unë edhe sot po përpiqem të flas në mënyrë neutrale. Duke u munduar që të analizojmë situatën e jo të anojë, të paraqes qëndrimin e njërit apo tjetrit, përkundrazi, po mundohem të gjej një linjë të mesme, kurse përndryshe do të mund të flisja edhe ndryshe, e jo ashtu si do të kisha dëshiruar, qartazi ajo nuk është realiteti dhe nuk mund të jetë ashtu. Ne duhet patjetër të marrim parasysh këtë realitet. Realiteti është një: që Kosova njëanshëm e ka shpallur pavarësinë. Realiteti tjetër është që serbët nuk e pranojnë këtë shtet të shpallur në mënyrë të njëanshme. Tani unë këtu kërkoj mundësinë politike të gjetjes së kompromisit, dialogut që të mos vijë deri te konflikti, por që me mjete paqësore politike të vijmë deri te zgjidhja. Unë kam thënë më heret dhe po e them edhe tani, po shihet qartë që këtu është shpallur pushteti shqiptar në teritore ku jetojnë shqiptarët dhe aty ku serbët janë pakicë të cilin mund ta kontrollojnë. Në anën tjetër, është dhënë mundësia që serbët me ndihmën e Serbisë të ruajnë sovranitetin në teritore, ashtu si mendojnë ata, në teritore ku jetojnë serbët. Ne duhet ta zgjidhim këtë fakt nëse duam të shkojmë tutje. A pajtohem unë me këtë apo jo, kjo është çështje tjetër. Për këtë arsye konsideroj se duhet ta marrim parasysh këtë realitet. Më duket sikur në një moment serbët nuk e kanë parë atë realitet, ashtu edhe sot as pala shqiptare nuk po e sheh këtë realitet. Vështrimi me kujdes i këtij realiteti na duhet për të gjetur me mjete politike përgjegjje në këtë pyetje. A do të jetë Kosova e pavarur dhe e njohur nga ana e Serbëve, sipas asaj se si qëndrojnë gjërat sot-jo! A është në gjendje ku pushtet t'i bëjë serbët për vete, sipas asaj se si punon dhe se çka kanë punuar prej vitit 1999-jo. Shqiptarët po ashtu thonë që nuk mund të pranojnë atë që ua ka bërë Serbia deri në vitin 1999, kurse Serbia nuk mund të pranojë Kosovën e pavarur për shkak të asaj se çka kanë bërë shqiptarët pas vitit 1999. Unë vetëm po mundohem të prezantoj faktet dhe të gjej përgjegjjet. Urgjentisht, sa më urgjentisht që është e mundur sepse koha ka ardhur për këtë. Unë propozoj që serbët dhe shqiptarët këtu në Kosovë, përveç pushtetit zyrtar, të formojnë një forum për dialog dhe pajtim. Një forum serbo-shqiptar apo shqiptaro-serb për dialog dhe pajtim. Që ne të jemi në funksion të amortizimit dhe krijimit të kushteve për të gjetur një zgjidhje politike. Pra, kjo është ajo çka kam menduar atëherë dhe çka mendoj tani. Unë nuk flas as nga pozita e pushtetit, as politikanëve, por më tepër si analist i cili ka dëshirë që ky problem të zgjidhet. Ju lutem, më 1912, kur Kosova u integrua në

Serbi, as shqiptarët nuk qenë shumë të lumtur. Ata pranuan, por kurrë nuk pranuan të integrohen, kanë pasur lëvizjen e tyre, me të cilën kanë punuar në ndërkohë për të arritur atë çka po arrijnë sot. Pra edhe serbët sipas asaj që unë di, nuk do ta pranojnë Kosovën e pavarur, por mund të pranojnë disa institucione, siç i pranojnë edhe sot, kurse sa i përket çështjeve të mëdha politike midis Beogradit dhe Prishtinës, komuniteti ndërkombëtar është këtu që të kërkojë zgjidhje, kurse ne të jetojmë jetën dhe të krijojmë kushte që së bashku të mbijetojmë këtu.

Nedjeljko Zejak: Unë do të bëj vetëm një konstatim të vogël, do të kishte qenë mirë që ne gazetarët të mos e transmetojmë atë çka tha zoti Vllasi sepse besoj që do të krijohet mllef edhe më i madh në mjediset serbe ndaj EULEX-it dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare. Pyetje për zotin Viktor, cilat ligje do të zbatohen në veriun e Kosovës? A është baza e prezencës suaj në Kosovë marrëveshja e shkurtit apo është baza e prezencës suaj vendimi i Këshillit të Sigurimit dhe një pyetje për zotërinë nga ICO-ja. Ju theksuat që detyra juaj ekskluzive është dhënia e këshillave Qeverisë së Kosovës dhe zbatimi i udhëzimeve nga plani i Ahtisarit. Sa kjo bie ndesh me vendimin e Këshillit të Sigurimit dhe planin prej gjashtë pikave?

Viktor Rojter: mua më duhet të përsëris atë çka kam thënë për zbatimin e ligjeve ekzistuese, konsideroj që ligjet duhet të respektohen si dhe Kushtetuta, mendoj se këtë përgjegjeje e kam dhënë edhe më heret. Mendoj se kjo është bazë ligjore edhe për veriun. Mendoj se kjo është një përgjegjeje e qartë edhe për juve. Baza ligjore është marrëveshja e shkurtit.

Endi Mekgafi: Ju falemnderit për pyetjen. Po, me të vërtetë, detyra e ICO-së është që të këshillojë dhe kontrollojë punën e Qeverisë së Kosovës në zbatimin e propozimit gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Konsideroj që kjo është një mënyrë e mirë për pengimin e shpërthimit të konflikteve. Jam në dijeni për raportin e KS-së, që Kushtetuta është përpiluar dhe aprovuar nga ana e pushtetit në Kosovës. Ajo Kushtetutë përmban përkushtimin dhe obligimet edhe për zbatimin e planit gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. ICO-ja është këtu që të ndihmojë Qeverinë e Kosovës për të zbatuar këto obligime.

Tijana Arsiq-radio KIM: Zoti Trajković, a besoni se do të ketë biseda dhe negociata të reja midis Kosovës dhe Serbisë? Ndoshta edhe dikush tjetër do të donte të përgjigjej në këtë pyetje?

Momqillo Trajković: Unë thashë pak më parë që çështja e Kosovës nuk është zgjidhur. Do të kisha qenë i lumtur po të ishte e zgjidhur. Çështja e Kosovës nuk mund të zgjidhet mbi gju dhe brenda natës. Ajo duhet të zgjidhet përmes procesit të integriteteve evropiane, i cili është rasti ynë, unë nuk shoh mundësi që Kosova të kthehet në përbërje të Serbisë siç ka qenë dikur. Por integritet evropiane janë hapësira dhe mundësia në të cilën duhet të arrihet ndikimi ndaj Kosovës dhe Metohisë. Unë mendoj se do të ketë bisedime. Ja edhe kryetari Tadić e ka dërguar

porosinë, mendoj se kjo është një porosi e mirë. Unë edhe më heret, në vitin 1992, kur është biseduar me shqiptarët e ndershëm, kam thënë që duhet të bisedohet edhe me forcat reale. Pra, duhet të bisedohet me ata që janë nga Kosova dhe me ata që janë përfaqësues të popullit shqiptar. Me ata duhet të bisedohet dhe të kërkohet zgjidhje. Për fat të keq, shqiptarët po e përsërisin të njëjtin gabim të Millosheviqit dhe ata i kanë serbët e tyre që bashkëpunojnë me të cilët përpiqen të gjejnë zgjidhje, kurse siç po shihet nuk ka zgjidhje. Duhet të bisedojnë me forcat reale. Unë insistoj për forumin, ku do të ulej elita politike dhe të gjejë zgjidhje dhe të bëj presion te të dy pushtetet, ashtu që të hyjnë në procesin e zgjidhjes së problemit.

Moderatori: Zoti Rojter, në mënyrë që kolegu ynë të mos mbetet pa përgjegjje në pyetjen e tij, ju lutem të përgjigjeni a është EULEX-i këtu në bazë të vendimit të shkurtit apo në bazë të vendimit të KS-së të para disa ditëve?

Viktor Rojter: Edhe njëherë mjaft qartë. Ne jemi këtu në bazë të aktiviteteve të përbashkëta të 4 shkurtit. Juridikisht, vendimi i KS-së është përshëndetur por baza jonë ligjore është aktiviteti i përbashkët i shkurtit.

Azem Vllasi: Së pari cilat ligje do të vlejnë sipas pikave të kontestuara? Nëse keni vërejtur në letrën e Ban Ki Munit dërguar Boris Tadiqit, thuhet që EULEX-i do të veprojë në kuadër të sistemit unik ligjor në Kosovë. Dy sisteme ligjore, ai i UNMIK-ut dhe ai i Kosovës, nuk ekzistojnë. Së dyti për dialog dhe biseda, edhe pala kosovare është e interesuar për relaksim e raporteve midis serbëve dhe shqiptarëve. Ne jemi për biseda konkrete teknike me Serbinë, për normalizimin e marrëdhënieve midis qytetarëve. Bisedat politike për status janë kohë e kaluar. Vetëm një shpjegim, pasi që u përmend disa herë, pavarësi e shpallur në mënyrë të njëanshme nuk ekziston në të drejtën ndërkombëtare, dhe në praktikë në historinë e botës nuk ekziston. Nuk mbahet mend që ndonjë shtet e ka shpallur pavarësinë në mënyrë të dyanshme apo të shumëanshme, veçse akti i shpalljes është në të vërtetë akti i institucioneve përmes referendumit të popullit të atij shteti. Kurse nëse flasim për atë se si ka ardhur deri te pavarësia e Kosovës, atëherë është fakt që është i ndërlidhur me të gjitha shtetet e reja të formuara në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe një spektër i tërë qëndrimesh është dakorduar në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Po të kishte qenë me të vërtetë e njëanshme, atëherë ne sot nuk do të kishim pasur planin e Ahtisarit, por do ta kishte shpallur Kushtetutën, nuk ke EULEX, nuk ke KFOR.

Kosova Sot: Ne kemi pasur negociata sipas planit të Ahtisarit. Po të mos kishte propozuar ai, ne nuk do të kishim pasur as pavarësinë e mbikqyrur, serbët i kanë pasur përfaqësuesit nga Beogradi. A keni kërkuar ju përgjegjësi nga liderët që ju kanë përfaqësuar?

Momqillo Trajkoviq: Unë edhe atëherë publikisht e kam shprehur mospajtimin tim. Atëherë kam thënë që bisedave në Vjenë duhet t'u paraprijë biseda serbo-shqiptare në Kosovë, sepse për mua kjo është çështja kyçe, kurse për çështjen e statusit është dashur të bisedohet me Beogradin. Për fat të keq, unë edhe atëherë kam tërhequr vërejtjen që thelbi i këtyre bisedave, i kësaj loje, është që të tregohet se serbët dhe shqiptarët nuk janë në gjendje të gjejnë përgjegjjen, sepse po të ishin në gjendje ata as që do të kishin ardhur. Në të vërtetë, esenca atëherë ka qenë që të ndeshen dy cjep, e atëherë bashkësia ndërkombëtare të thotë që meqenëse ju nuk jeni të aftë, ja zgjidhja. Këtë e thoj unë, para se Ahtisari të paraqiste zgjidhjen e tij. Pra, kishte të bënte me raportin e forcave në botë. Këto janë fuqitë e mëdha. Para së gjithash Amerika, fuqitë perëndimore ndikuan që të merret një vendim i tillë. Mirëpo, ky vendim nuk u aprovua në KS. Pra, duke përjashtuar të drejtën ndërkombëtare. Tani Serbia po e udhëheq procesin. A do të ketë sukses apo jo? Serbët në Kosmet duan që ajo t'ia arrijë. Nëse nuk do të ketë sukses, nuk do t'i marrim armët dhe të gjuajmë? Jo, ne kërkojmë që kjo çështje të zgjidhet deri në fund. Prandaj, dilaogu është bërë dhe është braktisur, pse është braktisur? Për arsye se pala shqiptare e ka ditur paraprakisht që do të gjendet një zgjidhje në dobi të saj. Ne mund të themi çka të duam, ato biseda nuk kanë qenë, thënë më së buti të drejta, sepse është ditur se si ato biseda duhet të përfundojnë. Konsideroj që nuk duhet të bëjmë lëvizje që do të shkonin në favor të atyre që duan të ndajnë Kosovën. Unë jam kundërshtar i rreptë i ndarjes. Njëherë bile kam thënë që është më e mirë pavarësia e imponuar se sa ndarja dhe kjo ka qenë edhe në gazetën tuaj dhe kjo është mjaft e guximshme. Tani prapë po i them jo ndarjes së Kosovës sepse ndarja e Kosovës do të krijojë probleme edhe në Ballkan edhe në regjion. Ndarja e Kosovës do të thotë që po krijohen kushte dhe parime për përleshje. Në këtë aspekt konsideroj që përgjegjësinë e kanë edhe ata që e kanë udhëhequr dialogun sepse kanë sjell deri te shpallja e njëanshme e pavarësisë.

Jasmina Stojkoviç-TVMost: Zoti Viktor, unë nuk e kuptova se cila është arsyeja e shtyrjes së misionit deri më 9 dhjetor, e përmendët festën, ju lutem të më tregoni këtë. A do të ndodh që nëse do të paralajmërohen protesta më 9 dhjetor, ju do të shtyni misionin përsëri? Pra a ka mundësi që protestat e shqiptarëve të ndikojnë në të ardhmen në shtrirjen e misionit në bazë të Këshillit të Sigurimit, të cilin, e pranuat ju apo jo, duhet ta respektoni? Vetëm të më qartësoni. Cilat janë ato treva ku ju do të keni pushtetin ekzekutiv? Vetëm shkurt edhe për Viktorin dhe Ivankon, unë dje në Prishtinë pashë që një pjesë e misionit civil ku do të jetë EULEX-i dhe pjesa ku planifikohet të jetë UNMIK-u është rrethuar me tela me gjemba. A do të thotë kjo që ju nuk keni besim në njëri tjetrin?

Viktor Rojter: Unë do të filloj me përgjegjjen. Kur është në pyetje data, ne vetëm se kemi thënë që do të jetë në fillim të dhjetorit. Për mua 9 dhjetori është ende fillimi, e pse nuk ka qenë 1 apo 2 dhjetori këtë tashmë e shpjegova. Ne jemi të gatshëm të fillojmë qysh sot. Ne deshëm që këto ditë t'i shfrytëzojmë për diskutime të mëtutjeshme rreth këtyre ngjarjeve. Ne e kemi thënë edhe më heret që me datën pesë do të mbahet mbledhja e ambasadorëve të BE-së dhe ne duam të dorëzojmë raportin për gatishmërinë e misionit. Pastaj vie fundjava e cila nuk është e përshatshme për fillimin e misionit e edhe tetë dhjetori si festë zyrtare për njerëzit në Kosovë.

Festa nuk është fillim i mirë, kështu që kjo nuk ka lidhje me datën, por me atë që thashë më parë. Përndryshe, sa i përket pushtetit ekzekutiv, ai nuk është pjesa më e madhe e misionit tonë, mandati ynë precizon kur e përdorim pushtetin ekzekutiv. Do të thotë ne nuk kemi pushtet të plotë ekzekutiv. Nuk e përdorim automatikisht por vetëm kur të paraqitet nevoja dhe kur institucionet nuk mund ta bëjnë këtë për shkaqe teknike apo për rrethana tjera. Ne pra i mbështesim strukturat lokale. Siç e thashë më parë, pushteti ekzekutiv është i kufizuar dhe do të përdoret vetëm nëse ka nevojë për të. Kur bëhet fjalë për demonstratat, kurdo që të mbahen ato, unë konsideroj që kjo është një mënyrë normale e shprehjes së mendimit publik. Deri atëherë kur demonstratat do të jenë ashtu siç ishin dje, mendoj se nuk do të ketë probleme. Ne jemi të vetëdijshëm për faktin që EULEX-i është i pranuar në mënyra të ndryshme në Kosovë, nga ana e komuniteteve minoritare, nga Prishtina po ashtu, ku ka grupe të ndryshme që kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre...Unë mendoj që kjo nuk do të ndikojë në shtrirjen e misionit. Ekipi për planifikim është këtu që dy vite dhe ne do të punojmë për të gjitha komunitetet dhe besoni që kemi në shumë gjëra pozitive se negative. Ne përcjellim se çka po ndodh. E kemi qëllimin tonë dhe bashkëpunimin me Qeverinë.

Aleksandar Ivanko: Jeni të mirë...e keni vërejtur rrethojën. Rrethoja është aty për shkak të konferencave për shtyp që i kemi pasur dhe ende i takon UNMIK-ut por edhe hapësirat tjera që janë aty do t'i kthehen organizatave që iu takojnë. Për këtë arsye rrethoja është aty, ashtu që EULEX-i të ndahet nga ato organizata.

Jasmina Stojković: Ivanko, është fjala për rrethojën me gjemba e cila është simbol i mosbesimit. Më thuani se si do të jetë raporti midis UNMIK-ut dhe EULEX-it? A do të bashkëpunoni?

Aleksandar Ivanko: Është përgjegjësi e EULEX-it që të sigurojë sistemet e sigurisë. Thashë që do të duhet kohë që të largohet ajo rrethojë për shkak të atyre si i quajmë ne shitoreve. Ne kemi raporte të shkëlqyeshme me EULEX-in, i kemi ofruar mbështetjen tonë logjistike, zyret, LOG bazat, automjetet e të tjera, kështu që unë do të thoja se jemi shokë të mirë.

Koha Ditore: Ju e përmendët se në bazë të cilës marrëveshje do të bëhet shtrirja në Kosovë. E përmendët kompetencën në disa treva. A do të zbatohet ajo kompetencë edhe në gjashtë pikat e Ban Ki Munit, të rëndësishme për institucionet e këtushme, kur dihet që të gjitha institucionet dhe Kryeministri kanë refuzuar zbatimin e tyre?

Viktor Rojter: E dini që EULEX-i nuk ka qenë i kyçur në negociatat për gjashtë pikat, kështu që gjashtë pikat janë diçka që ka ndodhur pa kurrfarë ndikimi dhe intervenimi nga ana e EULEX-it.

Ne jemi të interesuar për rezultatin e këtyre gjashtë pikave. Ne kemi këtu edhe një punë në vendosjen e sundimit të ligjit, i cili i ndihmon të gjithëve këtu e veçanërisht atyre që jetojnë në trevat minoritare sepse presim që do të mundësohet liria e lëvizjes, vendime të drejta në gjyqësi dhe çështje pronësore. Të kthehem te gjashtë pikat, kishte shumë diskutim për rolin e ardhshëm dhe hapjes së rrugës për të mundësuar dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit dhe presim që një gjë e tillë të ndodh. Çka do të ndodh tani ne ende nuk jemi të kyçur në gjashtë pikat si mision.

Alleksandar Ivanko: Më lejoni të shtoj, asgjë nuk do të imponohet. Do të ketë biseda dhe konsultime. Mirëpo problemet duhet të zgjidhen, kemi nevojë për dogana në të gjitha vendkalimet, mendoj se të gjithë pajtohem me këtë, është e nevojshme që serbët e Kosovës të kthehen në punë në polici dhe ne të gjithë pajtohem me këtë. Tani varet nga diplomatët dhe jo vetëm nga UNMIK-u por edhe prej të tjerëve që të gjejnë mënyra për zgjidhjen e këtyre çështjeve të jashtëzakonshme dhe zgjidhja e këtyre çështjeve është në interes të Kosovës dhe kjo është ajo që është me rëndësi, por kjo nuk është diçka që do të imponohet. Këto janë mekanizmat e famshëm përcjellës të cilët i presim.

Momqillo Trajković: Unë do të thoja mu ashtu. Ne kërkojmë nga të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë që të jenë të qartë edhe për shkak të serbëve edhe për shkak të shqiptarëve. Demonstratat e djeshme në Prishtinë nuk i kanë rënë ndërmend dikujt vetëm se nuk ka se çka të bëjë, por për shkak se janë të pakënaqur me vendimet e bashkësisë ndërkombëtare, respektivisht Këshillit të Sigurimit, i cili aprovoi këto konkluzë. EULEX-i nuk është ndonjë organizatë që duhet të negociojë, të marr pjesë në marrjen e vendimeve në planin ndërkombëtarë. Ky është instrumenti të cilin e ka dërguar BE-ja për të zgjidhur problemin. Pra me biseda, qoftë ajo shatëll diplomacia ku merr pjesë edhe Havier Sollana të gjithë janë pajtuar të them ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së në Këshillin e Sigurimit. Kështu që kjo çështje nuk është mu ashtu. Unë e di që është vështirë dhe që ka pakënaqësi, por shikoni deri dje ishte vështirë dhe ka pasur pakënaqësi edhe nga ana serbe, dhe ja me diplomaci dhe politikë situatë është qetësuar pak dhe tani ka përpjekje që të qetësohet edhe pala tjetër, por në jetën reale do të vijë deri te zbatimi i vendimeve të politikës. Për këtë arsye unë i inkurajoj përfaqësuesit e EULEX-it dhe misionit ndërkombëtarë këtu, po edhe përfaqësuesit e UNMIK-ut, të cilët në një mënyrë duhet ta mbrojnë atë çka e ka aprovuar Këshilli i Sigurimit dhe duhet të jenë të qartë. Pa marr parqasysh disa mospajtime të mëdha, më mirë është të shkohet qartë dhe të thuhet që askush nuk ka fituar dhe që do të ketë edhe mjaft probleme, se sa të themi që ne do të zgjidhim vetëm këtë. Nuk do të mund të bëhet ashtu, sepse nëse zgjidhet ashtu do të ketë probleme në anën tjetër. Duhet të zbatohet atë që është dakorduar në Këshillin e Sigurimit dhe kjo është baza që misioni të instalohet në tërë teritorin e Kosovës, kjo është çështja kyçe dhe esenca është që misioni të funksionojë në tërë teritorin duke respektuar vendimet e bashkësisë ndërkombëtare dhe mendoj që kjo është politika të cilën duhet të udhëheqin institucionet e Kosovës.

Moderatori: Do të dëgjojmë edhe pyetjen e fundit për sot.

Zharko Joksimoviq: Planifikova ta pyes zotin Vllasi dhe t'ju përshëndes në emër të produksionit LINK dhe t'ju shpreh zhgënjimin tonë sepse na keni premtuar disa shërbime në Beograd si ambasador i ardhshëm, por ja që dëgjojmë që po shkoni për Mal të Zi, por për këtë do të flasim më vonë.

Azem Vllasi: Do t'ju ndihmoj përmes Malit të Zi.

Zharko Joksimoviq: Ka mbetur në të vërtetë shumëçka e paqartë nga këto përgjegjje. Ajo që nuk e kemi të qartë është a t'i besojmë zotit Rojter që ka mbështetjen e Qeverisë së Kosovës. Ju jeni përndyshe mjaft të afërt me Qeverinë e Kosovës dhe supozoj që e dini. Atë për çka nuk do t'isha pajtuar me zotin Trajkoviq është kur tha që shqiptarët edhe dje edhe para disa ditësh, kanë protestuar në një masë të madhe edhe për motive sociale. Ne kemi biseduar me shqiptarët në teren dhe ata na kanë thënë që politikanët e tyre po i ngrehin ata për hunde dhe që premtojnë gjithçka dhe që edhe më tutje një pjesë e madhe e njerëzve jeton me 40 euro. A merr pjesë edhe Qeveria e Kosovës në tërë këtë rrëfim, zoti Vllasi, në organizimin e këtyre protestave dhe potezave që do të bëhen në të ardhmen kundër misionit EULEX?

Azem Vllasi: Nuk duhet shtrembëruar esencën e këtyre protestave. Këto protesta, e pamë këtë dje, janë para së gjithash shprehje e frikës dhe pakënaqësisë e asaj që shihet mes dy pikave dhe që mund të betonojë ndarjen etnike të Kosovës. Edhe ashtu raportet nuk janë të mira, sepse aq jemi të gjithë, bile me këto përvoja negative ku fillon ndarja në baza etnike, kurse hapi tjetër është ndarja territoriale dhe hapi i tretë është përleshja, për këtë arsye është prezente frika, kurse këto pakënaqësi sociale e të tjera, paj nëse edhe për këtë do të ketë protesta, dhe të kishte arsye që gjysma e Kosovës të dal në protesta dhe jo vetëm në Kosovë por edhe në Maqedoni dhe Serbi. Pra duhet të dallohen, këto nuk janë protesta kundër bashkësisë ndërkombëtare as kundër EULEX-it, por janë protesta kundër frikës se çka mund të na gjejë me gjëra fluide dhe të padefinuara.

Momqillo Trajkoviq: Unë pajtohem këtu. Unë fola në fillim për çështje sociale dhe pikërisht insistova në çështje ekonomike dhe sociale por kur të mbyllet kjo për të cilën foli zoti Vllasi, askush nuk mund t'i ndalë njerëzit e uritur dhe të papunë të reagojnë për shkaqe sociale. Në fund të fundit është gjë e mirë kur rrëzohen Qeveritë për shkak të çështjeve sociale, atëherë hapet demokratizimi dhe vie një pushtet më demokratik, por këtu para së gjithash bëhet fjalë për një paralajmërim të fuqishëm. A është kundër bashkësisë ndërkombëtare, është, „non grata“ është Zanieri, kjo ishte një nga parullat e djeshme. Pra ishte kundër bashkësisë ndërkombëtare, sepse

kjo nuk vjen nga brendësia por nga një hutim që bashkësia ndërkombëtare deri në fund të plotësojë atë çka i ka premtuar shqiptarëve, sepse raporti i forcave për momentin është krejtësisht i ndryshëm prej atij ambienti kur të gjitha këto janë premtuar, por në thelb pajtohem që është frika, por frika që të mos jetë ajo që është premtuar.

Azem Vllasi. Momo pak më parë the që shqiptarët nuk janë përpjekur fare në Vjenë, sepse iu është premtuar pavarësia dhe vetëm e kanë pritur atë në pjetë, kjo nuk është e vërtetë. Po të na kishte qenë dhe po të kishim pritur ashtu siç duam ne, ajo nuk do ishte quajtur pavarësi e mbikqyrur, nuk do të kishte disa komponente të pranishme ndërkombëtare por do të ishte pavarësi e plotë kurse tjetra se kush sa ka bllokuar të gjitha këto, këtë e pamë. Serbia e mbërtheu pozicionin e saj rreth statusit të Kosovës me atë çka ka shkruar në Kushtetutën e saj. Shikoni Kushtetutën e Serbisë dhe do të shihni krahina autonome e Kosovës dhe Metohisë dhe krahina autonome e Vojvodinës, nëse gjeni ndonjë ndryshim në krahasim me Kushtetutën e Millosheviqit, ja...le të shohim këtë. Pra esenca e gjërave, por tani në teren, eja të shfrytëzojmë të gjitha të mirat e prezencës së EULEX-it për të forcuar sundimin e ligjit, që qytetarët të jenë të sigurt, t'ju kthehen çështjeve jetësore. Misioni nuk është në krahinën jugore serbe, por misioni është në shtetin e pavarur të Kosovës dhe mendoj që asnjë shqiptari në pushtet apo kudo qoftë nuk duhet t'i bie ndër mend të thotë që ju duhet të njohni pavarësinë. Kjo është çështje e ndjenjave, e jani të jetojmë në botën reale.

Nedjeljko Zejak: Zoti Vllasi, kah do të shkoni për Podgoricë, përmes veriut të Mitrovicës apo kah Rozhaja?

Azem Vllasi: Unë do të shkoj nëpër Kosovë. Nëpër Leposaviq, Rashkë, Rozhajë dhe në Podgoricë.

Moderatori: Me këtë përfundoi debati i sotëm. Ju falemnderit të gjithëve dhe ju dëshiroj një ditë të këndshme.